



QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të Programit të aktiviteteve nga fusha e mjedisit jetësor dhe natyrës në territorin e Qytetit të Shkupit për vitin 2021 („Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit” nr. 15/20), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për subvencionimin e familjeve dhe subjekteve të tjera në territorin e Qytetit të Shkupit për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2021

1. Përshkrimi i Thirrjes publike

1.1 Problemi kryesor në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, me të cilin ballafaqohet Qyteti i Shkupit, është cilësia e keqe e ajrit ambiental në qytet, veçanërisht grimcat partikulare (PM10 dhe PM2,5). Një nga arsyt kryesore për emetimin e këtyre grimcave është ngrohja e objekteve që nuk janë të lidhura me ngrohjen qendrore, para së gjithash, për shkak të djegies jo të plotë dhe joadekuate të drurëve të zjarrit, cilësisë joadekuate të drurëve dhe mënyrës së ruajtjes së tyre dhe përdorimit të stufave të vjetra, të amortizuara dhe teknikisht të parregullta, si dhe ngrohja me pastrim dhe mirëmbajtja jo e rregullt e oxhaqeve.

Masa synon arritjen e efekteve afatshkurtra dhe disa efekteve afatgjata:

- Arritja e djegies më të mirë,
- Reduktimi i gazrave të dëmshëm,
- Reduktimi i blozës,
- Mbrojtja nga zjarri,
- Zvogëlimi i shpenzimeve për ngrohje;
- Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës, dhe
- Ngritja e vetëdijes publike te qytetarët për nevojën e pastrimit të oxhaqeve.

1.2. Mjetet financiare për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të bëra për pastrimin e oxhaqeve janë në vlerë neto maksimum deri në 1.200,00 denarë për familje, përkatësisht për subjekt juridik. Tatimi personal mbi të ardhurat është në barrën e Qytetit të Shkupit.

1.3. Në Thirrjen publike për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të familjeve dhe subjekteve të tjera për pastrimin e oxhaqeve mund të marrin pjesë persona fizikë ose juridikë vendbanimi i të cilëve, përkatësisht selia është në territorin e qytetit të Shkupit (komunat e qytetit: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj).

1.4. Thirrja publike do të zgjasë nga dita e shpalljes duke përfshirë aktivitetet e realizuara për pastrimin e oxhaqeve deri më 30.11.2021, përkatësisht deri në

shfrytëzimin e mjeteve të parashikuara për këtë qëllim në Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2021.

1.5. Thirrja publike është shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk), në mediumet e shtypura dhe elektronike (dhe atë më së paku në një nga gazetatat ditore në gjuhën maqedonase dhe në një nga gazetatat ditore në gjuhën shqipe) dhe mediet elektronike.

2. Kriteria për pjesëmarrje në Thirrjen publike:

Aplikuesi është e nevojshme të plotësojë kriteret e mëposhtme për pjesëmarrje në thirrjen publike:

- Të jetë banor i qytetit të Shkupit (komunat në qytet: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizari, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj), pikërisht objekti i personit juridik të jetë me adresë në territorin e Qytetit të Shkupit;
- Adresa e pastrimit të realizuar të përputhet me adresën e kartës së identitetit të aplikuesit, përkatësisht me adresën e selisë së subjekteve të tjera;
- Pastrimi i oxhakut të jetë kryer nga profesionist i punësuar në firmë të regjistruar me shifrën e veprimtarisë 81.22 në përputhje me Klasifikimin kombëtar të veprimtarive;
- Objekti ku do të pastrohet oxhaku të mos jetë në fazën e ndërtimit dhe
- Të posedojë vërtetim në origjinal dhe kupon fiskal origjinal për kryerjen e pastrimit të oxhakut me datë nga 01.01.2021 deri në shterimin mjeteve të dedikuara për Thirrjen publike, por jo më vonë se 30.11.2021.

3. Mënyra e aplikimit në Thirrjen publike

3.1. Të drejtë për pjesëmarrje në këtë Thirrje publike kanë banorët e qytetit të Shkupit, si dhe personat juridikë të cilët kanë objekte afariste në komunat: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizari, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj, të cilët do të pastrojnë oxhakun në vendbanimin e tyre ose objektin afarist në territorin e Qytetit të Shkupit dhe do të depozitojnë aplikim në formë elektronike të shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit për shfrytëzimin e së drejtës për kompensim.

3.2. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe për të provuar që kriteret për pjesëmarrje janë plotësuar, aplikuesi pranë Qytetit të Shkupit duhet të depozitojë në formë elektronike dokumentet e mëposhtme:

- **Dëshmi për person fizik: Bashkëngjitur kartë identiteti e vlefshme e skanuar nga aplikuesi për vendbanim në qytetin e Shkupit (komunat e qytetit: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizari, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj), përkatësisht familja e personit fizik të jetë në territorin e Qytetit të Shkupit ;**

- **Dëshmi për subjekt juridik: Bashkëngjitur, gjendja aktuale e subjektit e skanuar jo më e vjetër se 6 muaj;**

- **Bashkëngjitur, llogari transaksioni e skanuar/xhiro llogari e skanuar e aplikuesit;**
- **Bashkëngjitur, vërtetim origjinal i skanuar për realizimin e pastrimit të oxhakut, të nënshkruar nga personi profesionist që ka pastruar oxhakun nga firma e regjistruar për veprimtarinë pastrim oxhaqesh, dhe**
- **Bashkëngjitur, llogari fiskale origjinale e skanuar nga firma e regjistruar për veprimtarinë pastrim i oxhaqeve (shifra 81.22 në përputhje me Klasifikimin kombëtar të veprimtarive).**

3.3. Vërtetimi për realizimin e shërbimit duhet të jetë lëshuar:

- Për persona fizikë në adresën në të cilën jeton aplikuesi, pikërisht në të njëjtën adresë banimi që është në kartën e identitetit.
- Për persona juridikë në adresën e objektit afarist të subjektit juridik për të cilin ka të bëjë gjendja aktuale;

3.4. Vetëm një person nga familja mund të depozitojë kërkesë për marrjen e kompensimit.

3.5. Personat juridikë mund të depozitojnë vetëm një kërkesë për marrjen e kompensimit.

3.6. Plotësimi i aplikimit për shfrytëzimin e së drejtës për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhaqeve me të dhënat personale/të dhëna për personin juridik do të jetë në dispozicion formë elektronike nëpërmjet: faqes së internetit të qytetit: www.skopje.gov.mk, aplikacii.skopjelab.mk ose direkt në link-un: <https://aplikacii.skopjelab.mk/odzaci/>.

3.7. Link-u do të shpallet në faqen e internetit të Qytetit: www.skopje.gov.mk nga fillimi deri në përfundimin e Thirrjes publike.

4. Mënyra e realizimit të së drejtës së kompensimit

4.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit sjell Aktvendim për miratimin e kërkesës dhe kompensimin e një pjese të shpenzimeve të bëra gjatë pastrimit të oxhaqeve.

4.2. Kryetari i Qytetit të Shkupit me propozim të Komisionit me Njoftim informon aplikuesin se aplikimi i depozituar nuk është miratuar nëse nuk plotëson kriteret e kësaj thirrjeje publike.